




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DECAN  
OPSTINA DECANI



## Kryetari i Komunës

Nr: 02 / Zyrtarisht

Datë: 09.02.2017

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit mbi Shërbim Civil si dhe Rregullores Nr. 21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, Kryetari i Komunës shpall këtë:

### K O N K U R S ( Brendshëm )

|                              |                                                |
|------------------------------|------------------------------------------------|
| Institucioni:                | Komuna e Deçanit                               |
| Drejtoria:                   | Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike         |
| Titulli i vendit të punës:   | Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Emergjencë |
| Kategoria funksionale/Grada: | Koeficienti-7.5                                |
| Numri i referencës:          | RN00001602                                     |
| Lloji i pozitës:             | Karrierës                                      |

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon punën e përgjithshme të sektorit dhe ndihmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për sektorin;
- Menaxhon stafin e sektorit, dhe në bashkëpunim me Drejtorin, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve cilësore;
- Në bashkëpunim me drejtorin, bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Në mënyrë periodike analizon gjendjen e sigurisë, për të cilën përgatitë raport me shkrim, dhe të njëjtin e paraqet të Këshilli Komunal i Sigurisë;
- Bashkëpunon në mënyrë të rregullt me Policinë e Kosovës, ku shkëmbehen informata me interes të dyanshëm;
- Bashkëpunon me Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe brigadat e zjarfikësve, me qëllim që të ketë gatishmëri për situata emergjente;
- Jep propozime dhe merr masa parandaluese si për çështje të sigurisë ashtu edhe parandalimin e katastrofave natyrore;
- Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara;

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejte aplikimi kanë të gjithë Shërbyesit civil në kuadër të Institucionit .

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatet e interesuar (Shërbyesit civil në kuadër të Institucionit).

**Shkollimi i kërkuar:** Diplomë Universitare.

**Aftësi / përvojë dhe attribute tjera që kërkojnë:** minimum 4 (katër) vite përvojë pune; të ketë aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhimin e punëve, shkathtësi kompjuterike, ( Word, Excel ).

**Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në ndërtesën e Komunës pranë: **Zyrës Pritëse.**

Konkursi mbetet i hapur 8 dite nga dita e publikimit nga data: **09-02-2017 deri 16-02-2017.**

Aplikacionit i bashkëngjitet kopja e dokumentacionit mbi kualifikimin, Ekstraktin e lindjes, përvojën e punës, certifikata të trajnimeve nëse ka, Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës, certifikata shëndetësore dhe dokumentacione tjera.

Kandidatet të cilët përzgjidhen në listën e ngushtë për interviste njoftohen me shkrim ose në telefon në afat ligjor nga personeli, kandidatet janë të obliguar, që të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimin, trajnimet dhe të gjitha ato dokumente të cilat janë dorëzuar në aplikacion, dhe të cilat duhet të verifikohen nga Komisioni intervistues.

“Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës”.

**Zyra e Personelit**